

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO

Dr. Elvin MEKA

5

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Organizimi praktik

Funksionet dhe organizmi i Thesarit të bankës janë unike për çdo institucion bankar, por nuk ndryshon parimi i manaxhimit të rreziqeve që sigurojnë këto njësi.

Thesari i bankës lidhet në mënyrë organike me njësinë bankare të manaxhimit të rreziqeve, nisur nga natyra e pandarë e organizmit të operacioneve të thesarit me manaxhimin e rreziqeve të ndryshme.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Mjedisi i Thesarit

Mjedisi operacional në të cilin vendoset dhe me të cilin ndërvepron Thesari përfshin operacionet e mëposhtme:

- 1. Përcaktimi i kuadrit të përgjithshëm të politikave bankare,**
- 2. Aktiviteti operacional në treg,**
- 3. Analiza e rrezikut dhe përputhshmëria ligjore,**
- 4. Operacionet e thesarit.**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Mjedisi i Thesarit

1. Përcaktimi i kuadrit të përgjithshëm të politikave bankare:

Atribut thelbësor i Komitetit të ALCO-s. Përfshin:

- **Hartimin e politikave të përgjithshme operacionale të veprimeve të thesarit të bankës,**
- **Pozicionimin strategjik të aktiveve,**
- **Përcaktimin e portofolit standard të investimit (*benchmarking*),**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Mjedisi i Thesarit

2. Aktiviteti operacional në treg (front office):

Atribut operacional i Thesarit që synon financimin deficiteve dhe investimin e tepricave të likuiditetit që synojnë:

- Financimin e bankës,**
- Investimin e fondeve dhe manaxhimin e rrjedhave të parasë.**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Mjedisi i Thesarit

3. Analiza e rrezikut dhe përputhshmëria ligjore (middle office):

Ka për qëllim:

- **Vlerësimin dhe matjen e rreziqeve që merren përsipër gjatë ekzekutimit të transaksioneve të thesarit,**
- **Matja dhe analizimi i ecurisë së investimeve,**
- **Raportimet e bazuara në analizat e rrezikut,**
- **Sigurimin e përputhshmërisë së operacioneve me aktet ligjore në fuqi.**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Mjedisi i Thesarit

4. Operacionet e thesarit (back office):

Kanë për qëllim:

- **Administrimin e *cash*-it,**
- **Marrëdhëniet me bankat korrespondente,**
- **Shlyerjet respektive të transaksioneve,**
- **Kontabilizimi i veprimeve të thesarit.**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe ALCO

Roli i Thesarit në ALCO:

- *Anëtar i ALCO-s;*
- *Mbikëqyret nga ALCO;*
- *I ofron ALCO-s informacion mbi tregun;*
- *Udhëzon bankën mbi manaxhimin e përditshëm të aktivitetit bankar.*

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave

Në bankingun modern deget bankare konsiderohen dhe trajtohen si njësi biznesi (profit center), brenda bankës.

Në këtë kuadër, bilanci i një dege nuk duhet domosdoshmrisht të jetë i balancuar, pasi dega mund të ketë gjendje më të madhe të huave sesa depozita dhe anasjelltas.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave

Disbalancat në bilancet e degëve mbyllen nga Thesari i bankës.

Tepricat e depozitave mbi huatë investohen nga Thesari në hua ndërbankare ose për shlyerje huash ndërbankare të marrë nga banka të tjera).

Deficitet e depozitave kundrejt huave mbulohen nga Thesari duke marrë hua në tregun ndërbankar.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave

Në të dy rastet e disbalancimeve si çmim i transferuar do të merret norma e interesit në tregun ndërbankar (norma e tregut).

Tregu ndërbankar shërben si një amortizues për situatën e likuiditetit të bankës (*liquidity cushion*).

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

*Thesari dhe transferimi i çmimit midis
depozitave dhe huave*

Afati i maturimit që përzgjidhet?

RREGULLI

I

PËRPUTHJES SË AFATEVE TË MATURIMIT!

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave

Afati i maturimit që përzgjidhet?

Për depozitën njëvjeçare si çmim i transferuar aplikohet norma njëvjeçare ndërbankare e interesit.

Për huanë dyvjeçare si çmim i transferuar aplikohet norma njëvjeçare ndërbankare e interesit.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave

Afati i maturimit që përzgjidhet?

Norma ndërbankare me maturime të përputhura (matched maturity interbank rate) quhet dhe Vlera Marzhinale e Fondeve me Maturime të Përputhura (Matched Maturity Marginal Value of Funds - MMMVF).

Çmimi i transferuar = MMMVF

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave

Çmimi i transferuar

Në përlllogaritjen e çmimit të transferuar merret në konsideratë niveli mesatar i normës ndërbakare për fondet dhe rezerva e detyrueshme, që mbahet pranë bankës qendrore.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave

Rregulli manaxherial

Objektivi kryesor në grumbullimin e depozitave dhe dhënien e huave është maksimizimi i marzhit neto të interesit (Net Interest Margin). Çdo marzh llogaritet në lidhje me MMMVF.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave

Rregulli manaxherial - Shembull

Supozojmë se depozitat me afat të grumbulluara nga një degë banke në Paris (70 mio EUR) janë me afat maturimi njëvjeçar. Norma ndërbankare tremujore është 5%, dhe norma ndërbankare njëvjeçare është 6%, ndërkohë që banka paguan 4% për depozitat.

Marzhi i interesit nga depozitat llogaritet:

Marzhi i interesit nga depozitat = $(6\% \times 70) - (4\% \times 70) = 1.4\%$

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave

Rregulli manaxherial - Shembull

E njëjta logjikë përdoret për rastin e marzhit të interesit për huatë.

Supozojmë se dega e bankës ka dhënë hua për individë (60 mio EUR) dhe biznes (40 MIO EUR) respektivisht me afat maturimi 1 dhe 2 vjeçar. Ndërkohë, normat ndërbankare 1 dhe 2 vjeçare janë respektivisht 6% dhe 7%, dhe banka i ofron huatë për individë dhe biznese me interes respektivisht 10% dhe 7.5%.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave

Rregulli manaxherial - Shembull

Marzhi i interesit për huatë llogaritet:

Marzhi i Interesit = marzhi nga keditë për individë + marzhi nga keditë për biznese =

$$= [(10\% - 6\%) \times 60] + [(7.5\% - 7\%) \times 40] = 2.6\%$$

Marzhi i interesit neto (NIM) nga depozitat dhe huatë:


$$\text{Total NIM} = 1.4 + 2.6 = 4\%$$

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave


Rregulli manaxherial

Çmimi i transferimit për depozitat dhe huatë



Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

Thesari dhe transferimi i çmimit midis depozitave dhe huave



Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALM

ALM – Asset & Liability Management:

Manaxhimi i aktiveve dhe detyrimeve është procesi sipas të cilit detyrimet bankare manaxhohen në mënyrë të tillë që t'i përshtaten:

- kërkesave për hua,**
- nevojave të likuiditetit dhe**
- kërkesave të bankës për aktivitet të sigurtë.**

Filozofia e ALM konsiston në objektivin e rritjes së aktiveve duke i përshtatur detyrimet e bankës sipas nevojave respektive të aktivitetit investues bankar.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALM

ALM – Asset & Liability Management:

Është një proces dinamik i Planifikimit, Organizimit dhe Kontrollit të Aktiveve & Detyrimeve – respektivisht i volumeve, elementëve përbërës, afateve të maturimeve, yield-eve dhe kostove, me qëllim sigurimin e një likuiditeti të qëndrueshëm dhe sigurimin e një të ardhure të kënaqshme.

Fokusi i ALM:

- 1. PËRFITUESHMËRIA***
- 2. OPERACIONALITETI AFATGJATË***

i bankës.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALM

ALM – Asset & Liability Management:

Objektivi afatshkurtër:

Sigurimi i likuiditetit, duke ruajtur potencialin e sigurimit të të ardhurave.

Objektivi afatgjatë:

Maksimizimi i vlerës ekonomike të bankës.

ALM monitorohet nga ALCO.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALM

Rëndësia e ALM:

Është një funksion shumë i rëndësishëm pasi:

- **Bankat janë institucione me përdorim të theksuar të levës financiare,**
- **Disbalanca midis flukseve hyrëse dhe dalëse të parave në banka është fenomen i përhershëm (fondet me afat të shkurtër investimet me afat të gjatë: *borrow short – lend long*).**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALCO

Komiteti më i rëndësishëm i drejtimit të bankës.

Funksionet kryesore të ALCO janë manaxhimi i:

- **Likuiditetit,**
- **Aktiveve,**
- **Detyrimeve,**
- **Mjaftueshmërisë së kapitalit,**
- **Zërat jashtë bilancit.**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALCO

Funksionet kryesore të ALCO janë manaxhimi i:

- Likuiditetit:

Sigurimi i fondeve të nevojshme nga banka për mbulimin e tërheqjeve të depozitave.

- **Aktiveve,**
- **Detyrimeve,**
- **Mjaftueshmërisë së kapitalit,**
- **Zërat jashtë bilancit.**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALCO

Funksionet kryesore të ALCO janë manaxhimi i:

- **Likuiditetit,**
- **Aktiveve:**

Zotërimi i aktiveve që siguronë kthimin më të madh dhe rrezikun më të vogël.

- **Detyrimeve,**
- **Mjaftueshmërisë së kapitalit,**
- **Zërat jashtë bilancit.**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALCO

Funksionet kryesore të ALCO janë manaxhimi i:

- **Likuiditetit,**
- **Aktiveve,**
- **Detyrimeve:**

Sigurimi i fondeve me kosto minimale.

- **Mjaftueshmërisë së kapitalit,**
- **Zërat jashtë bilancit.**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALCO

Funksionet kryesore të ALCO janë manaxhimi i:

- **Likuiditetit,**
- **Aktiveve,**
- **Detyrimeve,**
- **Mjaftueshmërisë së kapitalit:**

Mbajtja e një niveli të mjaftueshëm kapitali , duke siguruar njëkohësisht kthime të kënaqshme për aksionerët.

- **Zërat jashtë bilancit.**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALCO

Funksionet kryesore të ALCO janë manaxhimi i:

- **Likuiditetit,**
- **Aktiveve,**
- **Detyrimeve,**
- **Mjaftueshmërisë së kapitalit;**
- **Zërat jashtë bilancit:**

Mbajtja e tyre në nivele në përballueshme për bankën pa cënuar qëndrueshmërinë, aftësinë paguese, konkurrueshmërinë dhe fitimin e saj.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALCO


Përbërja e ALCO:

Anëtarët kryesorë:

- **Drejtori i Përgjithshëm (CEO),**
- **Drejtori Financiar (CFO),**
- **Drejtori i Manaxhimit të Rreziqeve (CRO),**
- **Drejtori i Thesarit**
- **Drejtori i Operacioneve**

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALCO



Thesari përgjegës për zbatimin e procesit të ALM.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALCO

KUSH bën ÇFARË:

- Financa:

Raporton mbi ecurinë dhe përfitimet.

- Risku:

Monitoron riskun dhe aprovon metodat e përdorura.

- Thesari (Zyra e ALM):


Përgatit e referon raporte risk-përfitim.

- Back Office:

Përpunon transaksionet dhe shlyerjet respektive.

Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALCO



Organizimi i Thesarit, ALM dhe ALCO 5

ALCO

